



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE

PLANI STRATEGJIK 2012 – 2014

QENDRA KOMBËTARE E EDUKIMIT NË VAZHDIM



QKEV falënderon konsulentët që ndihmuan në hartimin këtij plani: Laurent Duchastel, Besim Nuri, Zamira Sinoimeri, Kristina Voko si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, Urdhrit të Infermierëve të Shqipërisë, Urdhrit të Mjekut të Shqipërisë, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Institucioneve akademike publike dhe private, Shoqatave të profesionistëve për kontributin e tyre.

QKEV falënderon gjithashtu për mbështetjen e dhënë në hartimin e këtij plani Projektin “Sistemi për Zhvillim Profesional - II” i Qeverisë Zvicerane.

Plani strategjik 2012-2014 u miratua nga Ministri i Shëndetësisë, maj 2012.

Plani strategjik i QKEV-së 2012 - 2014

HYRJE

Çdo organizatë ka nevojë për një plan strategjik, që t'i shërbejë si një udhërrëfyes i përgjithshëm drejt veprimeve që duhet të ndërmerren në vitet në vazhdim. Ky plan duhet të jetë i përgjithshëm dhe specifik, realist, bazuar në burimet aktuale dhe vizionin për të ardhmen e organizatës dhe fuqizimin e mëtejshëm të saj. Ai duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë anëtarët e organizatës. Plani strategjik ndihmon në marrjen e vendimeve dhe shpërndarjen e burimeve, në koordinimin e veprimeve për të arritur qëllime të përgjithshme dhe koherente. Mbi të gjitha, plani *strategjik* është një ftesë për të hartuar një plan *veprimi*: ndërsa plani *strategjik* fokusohet në çfarë, pse dhe si, plani i *veprimit* fokusohet në kush, kur, sa dhe si (sa mirë). Duke qenë se plani i veprimit bazohet në planin strategjik, ky i fundit duhet të ketë prioritete të qarta.

Plani strategjik i QKEV-së

Aktivitetet e QKEV-së janë të njohura dhe janë zhvilluar që me fillimet e punës së qendrës. Personeli i QKEV-së është i motivuar dhe si në Tiranë ashtu dhe në rrethinat e saj ka pasur një zhvillim të mirë të aktiviteteve. Megjithatë QKEV po përballet tani me sfida madhore si fakti që rritja e numrit të aktiviteteve të akredituara nuk po ndodh me ritmin e duhur, dhe ende ky numër aktiviteteve është larg të qenit i mjaftueshëm për t'iu përgjigjur nevojave kombëtare; lindja e vështirësive të reja menaxheriale si pasojë e rritjes së numrit të detyrave që duhen kryer nga QKEV; nevoja për të përmbushur kërkesat dhe dëshirat e aktorëve kryesorë të edukimit në vazhdim.

Po kështu, janë diskutuar projekte dhe orientime të reja, disa në mënyrë konkrete siç është shtrirja e QKEV-së në qytete të tjera, nxitja e projekteve pilotë të të mësuarit në distancë dhe nxitja aktivisht e ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Çfarë duhet bërë në fillim? Në çfarë rendi? A ka mbivendosje të këtyre aktiviteteve? Në çfarë mase?

Plani strategjik i QKEV-së vë pak rregull për sa u takon këtyre sfidave dhe ideve zhvillimi. Ai nuk specifikon të gjitha mjetet, qëllimet dhe burimet për secilën prej tyre (për këtë shërben plani i veprimit), por jep një orientim të përgjithshëm për secilën prej tyre. Plani strategjik i QKEV-së është hartuar në atë mënyrë që veprimet që duhet të ndërmerren QKEV rrjedhin natyrshëm prej tij.

Misioni

Misioni i një organizate është boshti kryesor i veprimtarisë së saj. Ai është para së gjithash arsyeja përse është krijuar organizata; ai shpreh disa prej vlerave themelore të saj dhe specifikon disa prej qëllimeve që organizata do të arrijë. Një plan i rëndësishëm strategjik duhet jo vetëm të respektojë misionin mbi të cilin është ngritur, por edhe ta përforcojë atë.

Misioni i QKEV-së është si më poshtë:

QKEV është një agjenci publike që menaxhon dhe mbështet sistemin e zhvillimit profesional për profesionistët e kujdesit shëndetësor duke zhvilluar e nxitur standardet e cilësisë në edukimin në vazhdim dhe koordinon programin e ricertifikimit për të përmirësuar cilësinë e kujdesit shëndetësor në Shqipëri.

Tre aktivitete kryesore që rrjedhin prej këtij misioni janë:

1. Të zhvillojë standardet e cilësisë së edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë
2. Të promovojë standardet e cilësisë së edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë
3. Të koordinojë programet e ricertifikimit të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.

Këto tre folje veprorë *të zhvillojë, të promovojë dhe të koordinojë* janë në qendër të planit strategjik të QKEV-së.

Fokusi te zhvillimi

Folje sinonime të foljes *zhvilloj* janë *krijoj, zotëroj, përparoj, përmirësoj, përgatis, modernizoj, dhe modifikoj*. Kjo do të thotë që QKEV duhet të jetë shumë proactive dhe me iniciativë në veprimtarinë e saj të përditshme duke imponuar standarde të reja, duke krahasuar aktivitetet dhe shërbimet e saj me ato të ofruara nga organizata të ngjashme në vende të tjera, duke bërë vazhdimisht vetëvlerësime, duke zgjeruar marrëdhëniet me partnerët e ofruesit dhe duke rritur vazhdimisht nivelin e cilësisë së të gjitha aktiviteteve të zhvilluara nga ofruesit.

Fokusi te promovimi

Folje sinonime të foljes *promovoj* janë *mbështes, nxis, favorizoj, ngre, inkurajoj, popullarizoj, ekspozoj, dhe stimuloj*. Kjo do të thotë që QKEV duhet të jetë një agjent ndryshimi në mjedisin e saj dhe drejtuesi kryesor i ndryshimeve sektoriale duke ndërgjegjësuar si profesionistët e shëndetësisë ashtu edhe publikun mbi çështjet e ricertifikimit, duke shfrytëzuar çdo mundësi për të prezantuar dhe mbrojtur edukimin në vazhdim në sistemin e kujdesit shëndetësor shqiptar, duke mbështetur ofruesit në forma të ndryshme për të ofruar edukim cilësor në të gjithë vendin, duke lobuar në vazhdimësi me agjenci të ndryshme qeveritare dhe organizata private për të siguruar fonde të mjaftueshme dhe mbështetje ligjore të përkohshme, dhe duke mbajtur një rrjet aktiv bashkëpunimi mes ofruesve dhe palëve të interesuar për edukimin në vazhdim.

Fokusi te koordinimi

Sinonime të foljes *koordinoj* janë *organizoj, rendis, rregulloj, dhe realizoj*. Kjo do të thotë që QKEV duhet të veprojë si një *grand maestro* e edukimit në vazhdim në sistemin shëndetësor shqiptar duke siguruar që oferta t'i përgjigjet kërkesës, duke regjistruar e monitoruar nga afër çdo aktivitet, duke zbatuar standardet e cilësisë, duke parandaluar konflikte të mundshme etike midis interesave private dhe të ofruesve të aktivitetit, dhe duke siguruar një shpërndarje të drejtë të aktiviteteve përgjatë vitit dhe në të gjithë vendin.

Harta orientuese strategjike për vitin 2012-2014


Bazuar në misionin e QKEV-së, veprimet strategjike për vitet që vijnë kanë tre (3) boshte logjike:

- 1. Përmirësimi i CILËSISË dhe MONITORIMIT** të aktiviteteve të edukimit në vazhdim duke përmirësuar proceset e akreditimit me një ekzaminim më nga afër të kurrikulës, më shumë mbështetje të ofruesve, më tepër ndjekje e aktiviteteve të zhvilluara, zhvillim dhe promovim të qasjeve të reja pedagogjike, dhe integrim të ekspertizës dhe mjeteve vlerësuese në vlerësimin e aktiviteteve.
- 2. Përmirësimi i NDËRGJEGJËSIMIT dhe PJESËMARRJES** në aktivitetet e edukimit në vazhdim përmes fushatave efektive informuese mbi kërkesat e ricertifikimit dhe akreditimit, promovimit më të mirë të aktiviteteve ekzistuese, rekrutimit të ofruesve të rinj, mbështetjes dhe nxitjes së aktiviteteve që i'u drejtohen specialiteteve mjekësore ose zonave specifike.

3. **Përmirësimi i BASHKËPUNIMIT dhe SINERGJISË** përmes komunikimit të rregullt me të gjithë partnerët, prezencës aktive në qyte të tjera, rritjes së bashkëpunimit mes aktorëve kryesorë të përfshirë dhe ofruesve, dhe monitorimit më të mirë të iniciativave lokale.

Këto boshte do të konkretizohen në katër (4) angazhime madhore për nga prioriteti, të cilat duhet të përmbushen brenda të njëjtës periudhë.

1. **Rritja e aktiviteteve**, që nënkupton disa sfida në lidhje me organizmin e forcës së punës së QKEV-së, buxhetit, procedurave dhe marrëdhënieve me ofruesit;
2. **Decentralizimi përmes njësive të QKEV-së**, që është një projekt më vete, i cili ka për qëllim ngritjen e dy ose tre njësive të përhershme në dy ose tre qytete të përzgjedhura;
3. **Të mësuarit në distancë dhe andragogjia**, që është sa një orientim aq edhe një projekt më vete; një prirje për të zhvilluar një format dhe përmbajtje më të përshtatshme të aktiviteteve; një projekt për të nxitur zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive të edukimit në distancë me qëllim që të rritet ofrimi i edukimi në vazhdim në zonat e largëta dhe cilësia e përgjithshme e aktiviteteve me ndihmën e ekspertizës së huaj;
4. **Komunikimi i koordinuar**, i cili mund të arrihet vetëm me ndihmën e një plani strategjik komunikimi, që është gjithashtu një projekt më vete.



Çështje strategjike

Ndërsa boshtet dhe prioritetet synojnë të orientojnë organizatën në drejtimin e duhur, veprimet reale që rrjedhin prej tyre janë shumë dhe mbulojnë nëntë (9) çështje strategjike, që janë si më poshtë:

1. Përmirësimi i cilësisë së akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim (AEV) në kuadrin e ndryshimeve strategjike
2. Përmirësimi i procesit të monitorimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim (AEV)
3. Përballimi i rritjes së punës së QKEV-së, në lidhje me akreditimin dhe ricertifikimin

4. Përmirësimi i nivelit të pjesëmarrjes dhe mundësisë për të marrë pjesë në aktivitetet e edukimit në vazhdim (AEV)
5. Nxitja e larmisë së aktiviteteve të edukimit në vazhdim (AEV)
6. Mbështetja e trajnerëve dhe ofruesve të AEV në fuqizimin e aftësive të tyre në fushën e pedagogjisë për të rritur/ andragogjisë
7. Matja, vlerësimi dhe përmirësimi i impaktit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim në sektorin e kujdesit shëndetësor në Shqipëri
8. Rritja e publicitetit të QKEV-së në lidhje me misionin, mandatin, veprimtarinë dhe kërkesat e edukimit në vazhdim
9. Realizimi i ndryshimeve në infrastrukturë dhe përmirësimeve operative dhe në fushën e informacionit

Për çdo çështje strategjike ka një sërë veprimesh që duhen ndërmarrë në vitet në vazhdim. Për çdo veprim (31 veprime gjithsej) ka disa objektiva, mjete, burime, indikatorë të performancës dhe një kufi kohor. Tabela më poshtë tregon një detajim paraprak të këtyre veprimeve.

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
1	Përmirësimi i cilësisë së akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim (AEV) në kuadrin e ndryshimeve strategjike					'12 '13 '14	1 2 3
1.1	Përmirësimi i standarde ve dhe kriterëve të AEV bazuar në dokumentin rregullator (aktualisht në proces)	Të monitorohen me më shumë efikasitet aktivitetet që zhvillohen Të thjeshtohet procesi i akreditimit për aplikimet e reja	Rishikimi i dokumenteve dhe procedurave ekzistuese Më shumë njohuri në lidhje me praktikatat më të mira të AEV	Punonjësit e QKEV -së Komiteti ndërdisiplinor dhe disa aktorë të tjerë të edukimit në vazhdim	Dokumente, formularë dhe procese të reja formale të zhvilluara Botim i udhëzuesve të rinj më të qartë e të plotë	x	1
1.2	Fuqizimi i kapaciteteve të stafit të QKEV-së në lidhje me zbatimin e standardeve dhe kriterëve të akreditimit	Të zvogëlohet gabimi në procesin e akreditimit Të pakësohet koha e procesit të vlerësimit dhe akreditimit	Krijimi i një rutine trajnimesh për çdo punonjës mbi procedurat dhe standardet e akreditimit Monitorim i dyfishtë rastësor i një kampioni aktiviteteve të akredituara Kontroll rastësor mes kolegëve i regjistrimit të krediteve individuale dhe listave të pjesëmarrjes në AEV	Statistika të mbledhura	Zvogëlimi i gabimit në procesin e akreditimit (vlerësuar çdo gjashtë muaj) Shkurtimi i kohës mesatare që kërkon procesi i akreditimit (vlerësuar çdo gjashtë muaj)	x x x x x	1
1.3	Asistencë për ofruesit e AEV-ve në lidhje me vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e aktiviteteve të tyre	Të thjeshtohet akreditimi i aktiviteteve përmes një planifikimi më të mirë të tyre Të përmirësohet cilësia e AEV përmes një procesi më të mirë të vlerësimit të nevojave dhe planifikimit të	Rritja e mbështetjes së ofruesve nga stafi me përvojë të QKEV-së Rishikimi i modeleve për zhvillim të aktiviteteve të reja të edukimit në vazhdim	Punonjësit e QKEV-së këshillojnë ofruesit e ndryshëm në bazë të përvojës së tyre Trajnime për rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve të QKEV-së	Reagime vlerësuese joformale nga ofruesit e AEV Vlerësim formal i kënaqësisë së ofruesve të AEV	x x x	1 2 3

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
1.4	Rritja e numrit të mjekëve dhe ekspertëve të tjerë që bëjnë pjesë në burimet e QKEV -së	Të zvogëlohet varësia nga të njëjtët ekspertë Të zgjerohet fusha e ekspertizës së QKEV-së në fusha të reja, kryesisht për sa i takon edukimit në vazhdim të specialiteteve të ndryshme mjekësore	Rivlerësimi i politikave inkurajuese për ekspertët Rritja e bashkëpunimit brenda komuniteteve të profesionistëve të shëndetësisë Përfshirja e më shumë ekspertëve nga diaspora kudo në botë Favorizimi i përfshirjes së ekspertëve të rinj duke kufizuar numrin e herëve që një ekspert mund të kontribuojë brenda një periudhe të caktuar BRA shton në listën e ekspertëve emrat e ekspertëve nga spitale dhe institucione akademike publike ose private rajonale	Komunikimi i mirë gjatë gjithë aktivitetëve të QKEV-së	Rritja e numrit të ekspertëve aktivë brenda grupit të ekspertëve (matur çdo gjashtë muaj) Shpërndarje e drejtë e ngarkesës brenda grupit të ekspertëve	x x	1 3

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
1.5	Përmirësimi i cilësisë së vlerësimit të përmbajtjes së aktivitetit të bërë nga eksperti	Të përmirësohet e standardizohet praktika e vlerësimit Të rritet ndërgjegjësimi mbi seriozitetin e procesit të ekspertizës	Komunikimi i udhëzimeve dhe pritshmërive të qarta ekspertëve Komunikimi i ndryshimeve në dokumentet rregullatorë ekspertëve Vlerësimi rastësor anonim i një kampioni vlerësimesh të ekspertëve të AEV kryer nga kolegu për kolegun Regjistrimi i ekspertëve që refuzojnë të bëjnë ekspertizën ose që bëjnë vlerësime të dobëta dhe raportimi i tyre vjetor pranë BRA-së	Fonde të buxhetit për ekspertizën e dyfishtë	Vlerësimi cilësor	x x x	x 1
1.6	Shtirirja e procesit të standardizuar të akreditimit dhe ekspertizës së QKEV-së në njësi të tjera të QKEV-së	Të ruhet cilësia e procesit të akreditimit në të gjitha njësitë e QKEV-së Të ndahet ekspertiza me stafin e këtyre njësive	Krijimi i linjave të qarta të komunikimit midis njësive të QKEV-së dhe qendrës Rritja e bashkëpunimit me organizatat lokale që bashkëpunojnë me njësitë e QKEV-së	Fonde të buxhetit	Për tu përcaktuar	x x x	1 2

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
2	Përmirësimi i procesit të monitorimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim (AEV)					'12 '13	'14 1 2 3
2.1	Rritja e numrit të aktiviteteve të monitoruara	Të sigurohet respektimi i standardeve dhe kriterëve të cilësisë dhe të përmirësohet cilësia e aktiviteteve të edukimit në vazhdim	Monitorim i rastësor i një kampioni të AEV duke ndjekur nga afër përmbajtjen e aktivitetit dhe mesazhet e dhëna	Punonjësit e QKEV -së, dhe të njësive të saj Përmirësim i procedurave të monitorimit	Rritja e numrit të aktiviteteve të monitoruara nga afër Ulja e numrit të aktiviteteve që paraqesin probleme etike ose shkelje serioze të kriterit të konfliktit të interesit	x x	x x 1
2.2	Intensifikimi i monitorimit të aktiviteteve të sponsorizuara nga firma private	Të shmangët konflikti i mundshëm i interesit midis ofruesve dhe kompanive private Të pakësohen sjellje të mundshme jo etike	Monitorimi i pjesëmarrjes në AEV dhe zhvillimit të tyre dhe marrja e masave kur është e nevojshme	Për tu përcaktuar	Për tu përcaktuar	x x x	2 3

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
3	Përbballimi i rritjes së punës së QKEV-së, në lidhje me akreditimin dhe monitorimin						
3.1	Decentralizimi i QKEV-së përmes ngritjes së dy ose tre njësive të QKEV- së në dy ose tre qytete të përzgjedhura	Të shtrihet QKEV-në rajone Të përmbushet mandati i QKEV-së në nivel kombëtar	Krijimi dhe zbatimi i një plani decentralizimi	Fonde të përshtatshme të vazhdueshme Bashkëpunim dhe komunikim aktiv me partnerët lokalë Identifikim i partnerëve lokalë, nëse është e nevojshme, me të cilët njësitë e QKEV-së mund të bashkëpunojnë dhe/ose të ndajnë mjediset e punës Proces i standardizuar i akreditimit	Për tu përcaktuar	x x	2
3.2	Thjeshtimi i proceduarave të akreditimit (aktualisht në proces)	Të lehtësohet përfshirja e ofruesve të rinj Të reduktohet ngarkesa e punës	Rishikimi i procedurave Thjeshtimi i akreditimit të aktiviteteve trajnuese ekzistuese në spitale	Punonjësit e QKEV-së Konsulentë lokalë	Vlerësime cilësore	x	2

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
3	Përballimi i rritjes së punës së QKEV-së, në lidhje me ricertifikimin dhe akreditimin					'12 '13	'14 1 2 3
3.3	Rekrutimi i stafit të ri për njësitë e QKEV-së	Të zvogëlohet ngarkesa e punës dhe të zgjerohen aktivitetet Të rritet ekspertiza	Detyra dhe pozicione të përshkruara qartë (përshkrime të punës) Kërkesë për rritje buxheti në ministri	Shtesë fondesh publike	Personeli i ri i rekrutuar	x x x x	1
3.4	Monitorimi i impaktit të programit të ricertifikimit dhe zhvillimi i kuadrit ligjor për ricertifikimin e infermierëve /mamive	Të përgatiten kushtet e nevojshme për rritjen e QKEV-së dhe zgjerimin e mandatit të saj Të përmbushet mandati i ri	Ndjekja aktive e këtij procesi me aktorët kryesorë dhe instancat e ministrisë Plani paraprak i komunikimit	Advokaci e QKEV-së	Raporte të QKEV-së	x x x x	2

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
4	Përmirësimi i nivelit të pjesëmarrjes dhe mundësisë për të marrë pjesë në AEV						
4.1	Realizimi i një studimi për të kuptuar përse disa profesionistë marrin pjesë më shumë në AEV dhe të tjerë më pak	Të identifikohen pikat e dobëta Të përmirësohet oferta e AEV dhe niveli i përshtatshmërisë së tyre	Kryerja e një studimi me komunitetin e profesionistëve Kryerja e intervistave më të detajuara me aktorët kyç dhe profesionistët	Një fond i vogël nga buxheti për kërkime (PDS-2) Bashkëpunim me kërkues akademikë	Raporti i studimit	x x	2
4.2	Zhvillimi i AEV në zona të largëta rurale duke nxitur ofrues të rinj ose duke përsëritur aktivitete të zhvilluara më parë në zona të tjera	Të rritet oferta Të përfitohet nga rritja e ofertës Të rritet vetëmjaftueshmëria e ofruesve dhe bashkëpunimi në rrjet Të rritet ndërgjegjësimi	Fokusimi në lidhjet mes institucioneve shëndetësore Përdorimi i influencës së njësive të QKEV-së Nxitja aktive e ofruesve të rinj Promovim aktiv i kërkesave të edukimit në vazhdim të profesionistët e shëndetësisë	Punonjësit e QKEV-së dhe burime të tjera - PDS-2	Rritja e numrit të aktiviteteve në zonat e largëta Rritja e numrit të ofruesve	x x x x x x	2
4.3	Mbajtja, publikimi dhe promovimi i një kalendari vjetor kombëtar të AEV	Të rritet oferta Të rritet pjesëmarrja Të rritet publiciteti i QKEV-së dhe ofruesve	Bërja dhe përditësimi i një liste aktiviteteve të akredituara, me informacionin e nevojshëm Publikimi i kalendarit në faqen zyrtare të QKEV-së	Burimet dhe punonjësit e QKEV-së	Kalendari i plotë dhe i përditësuar në website	x x x x x	2

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
5	Nxitja e larmisë së aktiviteteve të edukimit në vazhdim (AEV)						
5.1	Rritja e ekspertizës së QKEV-së në fushën e trajnimit	Të rritet cilësia e mbështetjes teknike të ofruar nga QKEV	Trajnimi i personelit të QKEV-së në lidhje me pedagogjinë dhe të mësuarin në distancë si brenda dhe jashtë Shqipërisë Identifikimi i ekspertëve të rinj	Stafi dhe burimet e QKEV-së PDS-2	Numri i njerëzve të trajnuar Numri i ekspertëve të jashtëm që bashkëpunojnë me QKEV-n	x x x	1
5.2	Nxitja e projekteve pilote me grupe profesionistësh si mjekët e familjes ose specialistë të ndryshëm	Të rritet vetëbesimi /siguria e ofruesve Të plotësohen kërkesat e grupeve të profesionistëve	Promovimi i qendrave klinike të referencës për mjekët e familjes dhe ekipet e tyre Promovimi i rezultateve të projekteve pilotë	Ofruesit Mbështetja teknike e QKEV-së PDS-2 Fonde të tjera, nëse janë të nevojshme	Numri i projekteve pilotë Numri i projekteve pilotë që më pas do të zhvillohen rregullisht dhe në mënyrë të përsëritur	x x x x x	2
5.3	Fillimi i punës për krijimin e një platforme të përbashkët teknike të edukimit në distancë për komunitetin e profesionistëve të shëndetësisë në Shqipëri	Të mbështetet decentralizimi i aktiviteteve, pjesëmarrja e profesionistëve nga të gjitha zonat periferike	Krijimi fillimisht i një sinergjie mes aktorëve kryesorë Vlerësimi i infrastrukturës teknike Krijimi i kushteve të domosdoshme për të zhvilluar dhe organizuar platformën	QKEV PDS-2	Website aktiv dhe i përditësuar si dhe burime të të mësuarit në distancë në përdorim nga pjesa më e madhe e ofruesve	x x x x	2

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
6	Mbështetja e trajnerëve dhe ofruesve të AEV në fuqizimin e kapaciteteve të tyre në pedagogji/andragogji					'12 13 14	1 2 3
6.1	Krijimi i një grupi ekspertësh dhe trajnerësh për trajnerë vendas dhe të huaj në fushën e andragogjisë	Të rritet asistenca teknike Të pakësohet ngarkesa e QKEV-së	Krijimi i një grupi ekspertësh dhe trajnerësh vendas dhe të huaj në fushën e andragogjisë	Identifikimi i ekspertëve të rinj në mes të stafit, aktorëve kryesorë, akademikëve dhe ekspertë të tjerë	Numri i ekspertëve	x x x x	1 3
6.2	Organizimi i trajnimeve të trajnerëve mbi parimet e andragogjisë në sektorin e shëndetësisë	Të transferohen njohuritë Të rritet cilësia	Uorkshop Kurse trajnimi Materiale trajnimi	Burime të QKEV-së PDS-2 Fonde të tjera	Rritja e numrit të trajnerëve të trajnuar Numri i aktiviteteve trajnuese	x x x x	2
6.3	Krijimi i një qendre dokumentacioni on-line në lidhje me pedagogjinë/andragogjinë	Të krijohet një 'arsenal' kombëtar ekspertize Të rritet transferimi i njohurive Të pakësohet varësia nga ekspertiza individuale	Abonimi në disa revista e gazeta profesionale Kryerja e një inventari website-sh dhe databazash në rrjet Blerja e librave, manualeve dhe udhëzuesve në lidhje me pedagogjinë/andragogjinë Vënia në dispozicion e disa prej këtyre burimeve përmes një portali të sigurt uebi.	Fonde të përshtatshme Një librari bazë Aftësi administrimi	Numri i dokumenteve Përdorim efektiv i dokumenteve (nr. i përdoruesve, etj.)	x x x	2 3

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
7	Matja, vlerësimi dhe përmirësimi i impaktit të AEV në sektorin e kujdesit shëndetësor në Shqipëri					'12 13 14	1 2 3
7.1	Vendosja e një bashkëpunimi aktiv me institucionet akademike dhe aktorë të tjerë për mbledhjen e të dhënave të kërimit	Të njihet dhe vlerësohet impakti i aktiviteteve të edukimit në vazhdim Të adresohen nevojat e menjëhershme Të përgatitet plani i ardhshëm strategjik	Përfaqësimi aktiv i QKEV-së në një rang të gjerë partnerësh Identifikimi dhe afrimi i organizatave ndërkombëtare aktualisht aktive në zona të ndryshme të vendit	Stafi i QKEV-së PSD-2	Numri i përfaqësimeve Numri i marrëveshjeve të bëra	x x x x	2 3
7.2	Ngritja e një grupi pune me aktorët kyç për të zhvilluar një mjet vlerësimi të efekteve dhe të impaktit të EV, dhe për ta pilotuar atë	Si më sipër Të rritet ndërgjegjësimi	Ngritja e një grupi pune me qëllime të qarta, kalendar pune dhe fonde të përcaktuara Kryerja e vlerësimit në bashkëpunim me ekspertët vendas dhe të huaj	QKEV PDS-2	Për tu përcaktuar	x x x	1 3
7.3	Nxitja e studimeve pilotë në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe institucione akademike	Si më sipër	Përfaqësimi aktiv i QKEV-së dhe krijimi i rrjetit të bashkëpunimit me individë dhe/ose organizata që do kryejnë studime të tilla Mbështetja e studimeve në aspektin teknik e logjistik	Studentë Studime në terren dhe studime të fizibilitetit	Numri i studimeve të kryera	x x x x	3

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
8	Rritja e publicitetit të QKEV-së në lidhje me misionin, mandatin, veprimtarinë dhe kërkesat e edukimit në vazhdim						
8.1	Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie të përgjithshme komunikimi	Të krijohet një imazh koherent i organizatës përmes veprimeve të koordinuara mirë Të arrihet efi kasiteti në komunikim	Zhvillimi i një plani strategjik të komunikimit me ndihmën e një eksperti të huaj	PSD-2	Plani efektiv i komunikimit	x x x x x	2
8.2	Mbajtja e një regjistri elektronik të plotë dhe të përditësuar të të gjithë institucioneve që duhen kontaktuar dhe profesionistëve që marrin pjesë në programin e ricertifikimit	Të arrihet një komunikim efektiv dhe i përmirësuar me një grup sa më të madh aktorësh Të mundësohet komunikim i lehtë dhe i shpejtë përmes një larmie mjeteve komunikimi Të shënohen aktivitetet e akredituara që ka ndjekur çdo profesionist në vend	Ruajtja e të gjithë informacionit	Stafi i QKEV-së	Përqindje e ulët e problemeve në komunikim (email-e të kthyer mbrapsht, etj.) Regjistri i plotë dhe i përditësuar për të gjithë profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit në të gjithë vendin me numrin e krediteve të mbledhura, AEV të ndjekura, etj.	x x x x x x	2 3
8.3	Botimi i dokumenteve informuese për grupe të ndryshme: profesionistë, agjenci kombëtare, organizata ndërkombëtare, ofrues të EV, etj	Si më sipër	Zhvillim dhe rishikimi i dokumenteve të prodhuara dhe mjeteve të tjera të komunikimit	Stafi i QKEV-së Plani efektiv i komunikimit	Dokumente të botuara Numri i profesionistëve të kontaktuar Numri i organizatave të kontaktuara	x x x	2

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
9	Realizimi i ndryshimeve në infrastrukturë dhe përmirësimeve operative dhe në fushën e informacionit						
9.1	Zgjerimi dhe përmirësimi i hapësirave të QKEV-së	Të krijohen mjedise që mundësojnë kryerjen e një numri më të madh aktivitetesh se ai aktual	Kërkesë për fonde të tjera nga ministria Shfrytëzimi optimal i hapësirave ekzistuese Kryerja e disa prej punëve jashtë zyrave ekzistuese	Stafi i QKEV-së Fonde	Ndërtesë me hapësirë / zyra të mjaftueshme për të gjitha aktivitetet	x x x	1
9.2	Vlerësimi i sistemeve ekzistuese të informacionit (kompjutera, database, etj.) dhe marrja e masave të duhura për të ruajtur cilësinë dhe lehtësimin e aktiviteteve të QKEV-së	Të përmirësohet efektiviteti i përpunimit të informacionit Të favorizohet shpërndarja e lehtë e informacionit të përditësuar aktorëve kyç Të mundësohet monitorimi i aktiviteteve në kohë reale	Kryerja e një analize të sistemit të informacionit bashkë me ekspertin e teknologjisë Zhvillimi i një plani emergjence brenda mundësive financiare të QKEV-së	Ekspertiza teknike		x x	1
9.3	Krijimi i procedurave koordinuese, raportuese dhe monitoruese midis njësive të QKEV-së dhe zyrës qendrore	Të ruhet kontrolli mbi aktivitetin e njësive dhe stafin e tyre Të harmonizohen praktikrat dhe standardet e zbatuara në njësitë e QKEV-së	Përcaktimi i proceduarve të qarta dhe zbatimi i tyre Përdorimi i teknologjisë për të ruajtur një lidhje të qëndrueshme me njësitë Kryerja e inspektimeve të parashikuara dhe të paparashikuara në njësitë e QKEV së	Përcaktim i qartë i punës dhe detyrave Menaxhim sipas objektivave Teknologjia e komunikimit për raportimet e nevojshme	Për tu përcaktuar	x x x	1

Nr.	Veprimi (çfarë?)	Objektivat (pse?)	Mjetet (si?)	Burimet (kush?)	Indikatorët (sa mirë?)	Kalendari	Boshti
9.4	Zhvillimi i një komunikimi të rregullt midis grupeve të interesit, institucioneve shëndetësore dhe ofruesve të AEV	Të përcaktohen nevojat prioritare për trajnim Të bëhen të njohura të dhënat, të transferohen njohuritë dhe të rriten standardet Të promovohen standardet Të rritet ndërgjegjësimi Të rritet bashkëpunimi Të mbështeten ofruesit dhe institucionet në rritjen e vetëbesimit në lidhje me AEV	Kryerja rregullisht e mbledhjeve koordinuese Mbajtja e komunikimit me partnerët kyç në lidhje me QKEV-n dhe AEV përmes raporteve, email-eve, etj. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta si konferenca, trajnime, etj.	Burimet e QKEV -së PDS-2 Burime të tjera	Numri i takimeve të kryera për një periudhë kohe Vlerësimet cilësore të pjesëmarrësve në lidhje me vlerën e këtyre takimeve dhe të informacionit të marrë.	x x x x x x	3

